

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 25.04.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të paraqitur nga Vane Andreev, avokat nga Strumica, nxori këtë:

KONKLuzion

Iniciativa për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, e paraqitur nga Vane Andreev, avokat nga Strumica, e evidentuar nën SU-03.nr.734/23 të datës 26.10.2023, **NUK MIRATOHET.**

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06 ... nr. 96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 25.04.2024 shqyrtoi mbi iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor për shlyerjen e dënimeve për të njëjtin person, i cili ka disa dënime të plotfuqishme, të paraqitur nga Vane Andreev, avokat nga Strumica.

Në iniciativën e paraqitur është parashtruar çështja: Për një të dënuar që ka disa dënime të plotfuqishme a mund të shlyhet çdo dënim individualisht kur të ketë kaluar afati i përcaktuar ligjor për fshirje nga evidenca dënuese, ose duhet të kalojë periodha e përcaktuar me ligj për të gjitha dënimet në mënyrë që të fshihen njëkohësisht.

Në bazë të nenit 103 paragrafi (1) nga Kodi penal, është përcaktuar se rehabilitimi i një personi të dënuar mund të bëhet me ligj (rehabilitim ligjor), ose në bazë të vendimit gjyqësor (rehabilitim gjyqësor).

Sipas paragrafit (2) nga i njëjti nen i ligjit, rehabilitim do të thotë ndërprerja e parakohshme e dënimeve që përbëhen nga ndalesat dhe nga dënimi dëbim i të huajit nga vendi dhe e pasojave juridike të dënimit dhe shlyerja e dënimit nga evidenca penale.

Sipas paragrafit (3) nga i njëjti nen i ligjit, personi i rehabilituar konsiderohet si i padënuar, ndërsa të dhënat për dënimin e shlyer nuk i jepen askujt.

Sipas paragrafit (4) nga i njëjti nen i ligjit, me rehabilitimin nuk preken të drejtat e personave të tretë të cilat mbështeten në bazë të dënimit.

Sipas nenit 104 nga Kodi penal, rehabilitimi ligjor përbëhet nga shlyerja e dënimit nga evidenca penale me ligj pas rrjedhjes së afatit të caktuar nga dita e plotfuqishmërisë së dënimit, përkatësisht nga dita e dënimit të vuajtur, parashkrimit ose dënimit të falur, nëse i dënuari në afat të përcaktuar ligjor nuk kryen vepër të re penale. Shlyerja e dënimit tërheq edhe ndërprerjen e të gjitha pasojave juridike nga dënimi, si dhe të dënimeve të shqiptuara që përbëhen në ndalesa, si për shembull ndalesa e kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës, ndalesa e drejtimit të automjetit, ose dënimi dëbim i të huajit nga vendi.

Rehabilitimi ligjor është i kufizuar në dënime më të lehta nga të cilat dënimi më i rëndë është dënimi me burgim deri në 3 vjet – paragrafi (4) nga neni 104 i Kodit penal.

Sa i përket kushtit themelor – i dënuari brenda afatit të caktuar të mos kryejë vepër të re penale, caktohen afate të ndryshme penale, varësisht nga pesha e dënimit.

Shlyerjen e dënimit kur janë të plotësuara kushtet për rehabilitim ligjor e bën gjykata kompetente për udhëheqjen e evidencës penale sipas detyrës zyrtare me aktvendim, dhe nëse gjykata nuk merr një vendim të tillë, personi i dënuar mund të kërkojë që të konstatohet se shlyerja e dënimit është bërë sipas nenit 495 dhe nenit 496 të Ligjit për procedurë penale.

Sipas nenit 104 paragrafi (1) të Kodit penal, dënimi për masën e shqiptuar alternative përveç dënimit me kusht dhe dënimit me të cilin kryerësi i veprës penale është liruar nga dënimi, shlyhen nga evidenca penale nëse i dënuari në afat prej 1-një viti nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor nuk kryen vepër të re penale.

Sipas paragrafit (2) nga i njëjti nen i ligjit, dënimi me kusht shlyhet nga evidenca penale pas 1-një viti pasi që do të kalojë koha për kontrollim, nëse gjatë asaj kohe i dënuari nuk kryen vepër të re penale.

Sipas paragrafit (3) nga i njëjti nen i ligjit, dënimi me para dhe dënimi ndalesë për të drejtuar automjetin, i shqiptuar si dënim i vetëm, shlyhet nga evidenca penale kur do të kalojnë 3-tre vjet nga dita e ekzekutimit, parashkrimit apo faljes së dënimit nëse gjatë asaj kohe i dënuari nuk kryen vepër të re penale.

Sipas paragrafit (4) nga i njëjti nen i ligjit, dënimet me burgim deri në 3-tre vjet shlyhen nga evidenca penale kur do të kalojnë 5-pesë vjet nga dita e ekzekutimit, parashkrimit apo faljes së dënimit nëse gjatë asaj kohe i dënuari nuk kryen vepër të re penale.

Sipas paragrafit (5) nga i njëjti nen i ligjit, më shumë dënime ndaj personit të njëjtë mund të shlyhen nga evidenca penale vetëm njëkohësisht edhe atë nëse ekzistojnë kushte për shlyerjen e çdonjërës prej tyre.

Paraqitësi i iniciativës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 05.12.2023, dorëzoi dy vendime gjyqësore edhe atë aktvendim të Këshillit penal pranë Gjykatës Themelore Penale Shkup KS-KR.nr.310/23 të datës 21.03.2023 dhe aktvendim të Gjykatës Themelore Strumicë KS-KR.nr.33/23 të datës 24.03.2023, ndërsa më 13.12.2023 dorëzoi pesë vendime gjyqësore për një person tjetër të dënuar edhe atë: aktvendim të Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.64/23 të datës 03.10.2023, aktvendim të Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.65/23 të datës 03.10.2023, aktvendim të Gjykatës Themelore Gjevgjeli KS-KR.nr.112/23 të datës 12.10.2023, aktvendim të Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.62/23 të datës 24.10.2023 dhe aktvendim të Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.63/23 të datës 24.10.2023, si prova për ekzistimin e vendimeve të ndryshme gjyqësore mbi këtë çështje të paraqitësit të iniciativës.

Në aktvendim të Këshillit penal pranë Gjykatës Themelore Penale Shkup KS-KR.nr.310/23 të datës 21.03.2023 është përcaktuar se dënimi nga evidenca penale ndaj të dënuarit Stevçe Stojanov nga Strumica, me të dhëna të përgjithshme si në kumtimin e aktvendimit, të shqiptuar me aktgjykim të Gjykatës Themelore Shkup I Shkup K.nr.1237/12 të datës 31.01.2013, i plotfuqishëm më 22.04.2013, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale – “Kallëzim i rrejshëm i veprës penale” nga neni 366 paragrafi (2) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit penal, për të cilën i është shqiptuar masë alternative – Dënim me kusht, në mënyrë që i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 – tre muaj dhe është vendosur që i njëjti nuk do të realizohet në qoftë se i dënuari në afat prej 1 – një viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër të re penale.

Dukshëm nga arsyetimi i këtij aktvendimi, gjykata ka konstatuar se njësia për evidencë penale dhe ndëshkuese pranë Gjykatës Themelore Strumicë me të dhënat SU.nr.01-465/23 të datës 10.03.2023, e ka njoftuar gjykatën se i dënuari Stevçe Stojanov nga Strumica figuron në evidencën penale të aktgjykimit të sipërcituar. Prokuroria Themelore Publike Shkup me KOV.nr.203/23 të datës 17.03.2023 i ka kthyer shkresat e lëndës, pa dhënë mendim për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale të këtij personi të dënuar në këtë rast. Gjykata ka konstatuar se lutja për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale për personin e dënuar, është bazuar në përputhje me nenin 104 paragrafi (2) të Kodit penal, në mënyrë që koha për kontrollimin e dënimit të shqiptuar me aktgjykim të Gjykatës Themelore Penale Shkup, atëherë ka qenë Gjykata Themelore Shkup I Shkup K.nr.1237/12 të datës 31.01.2013, i plotfuqishëm më 22.04.2023, koha e kontrollimit prej 1-një viti ka skaduar më 22.04.2014, ndërsa afati

ligjor prej 1-një viti në kuptim të dispozitës së cituar të Kodit penal ka skaduar më 22.04.2015 dhe në atë periudhë i dënuari nuk ka kryer vepër të re penale, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore për shlyerjen e dënimit me kusht nga evidenca penale në këtë rast.

Në aktvendimin e Gjykatës Themelore Strumicë KS-KR.nr.33/23 të datës 24.03.2023, kërkesa për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale e të dënuarit Stevçe Stojanov, me të dhënat si në kumtimin e aktvendimit, me aktgjykim të Gjykatës Themelore Strumicë K.nr.479/17, i plotfuqishëm më 08.10.2018, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale – “Mashtrimi” nga neni 247 paragrafi (3) në lidhje me paragrafin (1) në lidhje me nenin 45 paragrafi (3) të Kodit penal, i është shqiptuar Dënim me kusht, në mënyrë që i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1-një viti me kohë për kontrollim prej 3-tre vjet, është refuzuar si e pabazë.

Dukshëm nga arsyetimi i aktvendimit të theksuar gjykata ka bërë inspektim në listën e evidencës penale të Gjykatës Themelore Strumicë më 21.03.2023, në mënyrë që ka konstatuar se përveç aktgjykimit të plotfuqishëm, për të cilin personi i dënuar kërkon shlyerjen e dënimit, i dënuari në evidencën penale figuron edhe për aktgjykime penale tjera edhe atë:

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Strumicë K.nr.499/16 të datës 05.05.2017 me të cilin i dënuari Stevçe Stojanov është shpallur fajtor për vepër penale nga neni 247 paragrafi (1), (2) dhe (5) të Kodit penal, për të cilin i është shqiptuar Dënim me kusht ashtu që i është caktuar dënim me burgim prej 1-një vjet e 2-dy muaj me kohë për kontrollim prej 2-dy vjet e 6-gjashtë muaj. Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm më 17.06.2017;

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Prilep K.nr.256/13 të datës 05.05.2014, me të cilin i dënuari Stevçe Stojanov është shpallur fajtor për vepër penale nga neni 144 paragrafi (2) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit penal dhe i është shqiptuar Dënim me kusht ashtu që i është caktuar dënim me burgim prej 3-tre muaj me kohë për kontrollim prej 2-dy vjet;

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Prilep K.nr.293/16 të datës 01.03.2019, i dënuari Stevçe Stojanov është shpallur fajtor për vepër penale nga neni 202 paragrafi (1) të Kodit penal dhe i është shqiptuar dënim me para prej 67.650,00 denarë;

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Prilep K.nr.32/14 të datës 26.12.2014, me të cilin i dënuari Stevçe Stojanov është shpallur fajtor për vepër penale nga neni 144 paragrafi (2) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit penal dhe i është shqiptuar dënim me para prej 24.600,00 denarë;

Me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Penale Shkup K.nr.1237/12 të datës 22.04.2013, i dënuari Stevçe Stojanov është shpallur fajtor për vepër penale nga neni 366 paragrafi (1) të Kodit penal dhe i është shqiptuar Dënim me kusht, në

mënyrë që i është caktuar dënim me burgim prej 3-tre muaj me kohë për kontrollim prej 1-një vjet;

Nga këtu, sipas nenit 104 paragrafi (5) të Kodit penal, gjykata gjatë veprimit i është referuar kësaj dispozite duke qenë se disa dënime të një personi mund të shlyhen nga evidenca penale vetëm njëkohësisht edhe atë nëse ekzistojnë kushte për shlyerjen e secilës prej atyre dënimeve.

Në rastin konkret, Gjkata Themelore Strumicë në arsyetimin e aktvendimit ka konstatuar se sa i përket aktgjykimit të Gjykatës Themelore Strumicë K.nr.479/17, e plotfuqishme më 08.10.2018, për të cilën i dënuari ka kërkuar shlyerjen e dënimit në kohën e kontrollimit prej 3-tre vjet, dhe e cila ka skaduar më 08.10.2021 dhe gjatë një viti kur duhet të kalojë pas skadimit të kohës së kontrollimit, përkatësisht të datës 08.10.2022, për të dënuarin janë bërë të plotfuqishme edhe aktgjykime tjera për vepra të tjera të kryera penale edhe atë: me aktgjykim të Gjykatës Themelore Prilep K.nr.293/16, që është bërë i plotfuqishëm më 01.03.2019, me të cilin i është shqiptuar dënim me para dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Strumicë K.nr.504/16, i plotfuqishëm më 22.01.2018, me të cilin është dënuar me dënim me para, në mënyrë që gjykata nuk ka pasur provë se i dënuari i ka paguar dënimet me para, sipas neneve 109 paragrafi (1) pika 6 dhe nenit 111 paragrafi (5) të Kodit penal, të njëjtat janë parashkruar absolutisht më 01.03.2023, përkatësisht më 22.01.2022 kur ka filluar të rrjedh afati prej 3-tre vjet i paraparë në nenin 104 paragrafi (3) të Kodit penal, që për dënimin e parë do të skadonte më 01.03.2026, dhe për dënimin tjetër më 22.01.2025, kur për dënimet e theksuara do të realizoheshin kushte për shlyerjen nga evidenca penale.

Nga këtu, Gjkata Themelore Strumicë ka konstatuar drejtë se ende nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shlyerjen e dënimit.

Me aktvendim të Këshillit penal pranë Gjykatës Themelore penale Shkup KS-KR.nr.310/23 të datës 21.03.2023, me të cilin është përcaktuar shlyerja e dënimit të dënuarit Stevçe Stojanov, ky person figuron në evidencën penale të Gjykatës Themelore Strumicë për atë aktgjykim, për të cilin kërkohet shlyerje. Nga këtu, aktvendimi është marrë në mënyrë të drejtë sipas nenit 104 paragrafi (2) të Kodit penal, ashtu që i njëjti është ligjor dhe nuk është në dëm të personit të dënuar.

Në aktvendimin e Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.64/23 të datës 03.10.2023 është konstatuar shlyerja e dënimit nga evidenca penale ndaj të dënuarit Dejanço Kocev, me të dhënat si në kumtimin e aktvendimit, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Radovish K.nr.209/12 të datës 11.02.2013, i plotfuqishëm më 20.03.2013, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale – “Vjedhja e rëndë” nga neni 236 paragrafi (1) pika 3 në lidhje me nenin 45 të Kodit penal, për të cilën i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1-një vjet.

Dukshëm nga arsyetimi i këtij aktvendimi, gjykata ka konstatuar se lutja për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale e personit të dënuar është bazuar sipas nenit 104 paragrafi (4) të Kodit penal, në mënyrë që ka përcaktuar se dënimi është mbajtur në Burgun Strumicë më 17.03.2016, ndërsa kushti për shlyerjen e dënimit 5 vjet nga dënimi i vuajtur ka filluar më 17.03.2021 dhe në atë periudhë i dënuari nuk ka kryer vepër të re penale, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore për shlyerjen e dënimit me kusht nga evidenca penale.

Në aktvendim të Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.65/23 të datës 03.10.2023 është konstatuar shlyerja e dënimit nga evidenca penale ndaj të dënuarit Dejanço Kocev, me të dhënat si në kumtimin e aktvendimit, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Radovish K.nr.77/07 të datës 18.06.2007, i plotfuqishëm më 06.07.2007, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale – “Vjedhja” nga neni 235 paragrafi (1) të Kodit penal, për të cilën i është shqiptuar Dënim me kusht, ashtu që i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2-dy muaj, i cili nuk do të realizohet në qoftë se i dënuari në afat prej 2-dy vjet nuk kryen vepër të re penale.

Dukshëm nga arsyetimi i këtij aktvendimi, gjykata ka konstatuar se lutja për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale e personit të dënuar, është bazuar sipas nenit 104 paragrafi (2) të Kodit penal, në mënyrë që ka konstatuar se koha për kontrollim ka kaluar më 06.07.2009, ndërsa për atë kohë i dënuari nuk ka kryer vepër të re penale. Kushti për shlyerjen e dënimit ka filluar më 06.07.2010, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale.

Në aktvendimin e Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.62/23 të datës 24.10.2023 është konstatuar shlyerja e dënimit nga evidenca penale ndaj të dënuarit Dejanço Kocev, me të dhënat si në kumtimin e aktvendimit, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Radovish K.nr.85/12 të datës 13.09.2012, i plotfuqishëm më 04.10.2012, me të cilin është shpallur fajtor për vepër penale – “Vjedhja e rëndë” nga neni 236 paragrafi (1) pika 1 në lidhje me nenin 45 të Kodit penal, për të cilin i është caktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1-një vjet, i cili nuk do të realizohet në qoftë se i dënuari në afat prej 1-një viti nuk kryen vepër të re penale.

Dukshëm nga arsyetimi i këtij aktvendimi, gjykata ka konstatuar se lutja për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale e personit të dënuar, është bazuar sipas nenit 104 paragrafi (2) të Kodit penal, në mënyrë që ka konstatuar se koha për kontrollim ka kaluar më 04.10.2013, dhe për atë kohë i dënuari nuk ka kryer vepër të re penale. Kushti për shlyerjen e dënimit ka filluar më 04.10.2014, në mënyrë që janë plotësuar kushtet ligjore për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale.

Lidhur me aktvendimin e Gjykatës Themelore Gjevgjeli KS-KR.nr.112/23 të datës 12.10.2023 dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore Radovish KS-KR.nr.63/23 të datës

24.10.2023, të njëjtat janë dorëzuar jo të plota, përkatësisht pa faqen e dytë, në mënyrë që këto prova nuk mund të jenë lëndë vëzhgimi, shtjellimi dhe vlerësimi më të gjerë.

Nga këtu, duke marrë parasysh të theksuarën, gjykatat mbi lëndët e theksuara për të cilat janë dorëzuar aktvendimet e sipër theksuara, në mënyrë të drejtë i kanë zbatuar dispozitat e nenit 104 të Kodit penal, në mënyrë që në aktvendimin e Gjykatës Themelore Strumicë KS-KR.nr.33/23 të datës 24.03.2023 në mënyrë të drejtë gjykata e ka refuzuar kërkesën për shlyerjen e dënimit nga evidenca penale e të dënuarit duke qenë se nuk janë plotësuar kushtet për zbatimin e paragrafit (5) nga neni 104 të Kodit penal, duke qenë se kur ka disa dënime për të njëjtin person mund të shlyhen nga evidenca penale vetëm njëkohësisht dhe atë nëse ka kushte për shlyerjen e çdo njëres nga ato dënime.

Sipas nenit 37 paragrafi (1) të Ligjit të gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore me iniciativë në kushte të vendimeve të ndryshme gjyqësore për të njëjtën situatë juridike, përkatësisht kur ka lëshim të ligjit, që në këtë rast nuk ka.

Në bazë të sipër theksuarës, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi këtë iniciativë, dhe në diskutimin e mbajtur nxori Konkluzion, me të cilin iniciativa për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, e paraqitur nga Vane Andreev, evidentuar nën Su-03.nr.734/23 të datës 26.10.2023, nuk miratohet.

Seanca e përgjithshme
e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut